



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 544, datë 29.9.2021

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.536, DATË 1.5.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE,
QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË Durrës, TË QARKUT TË Durrësit", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në listën e inventarit të miratuar me vendimin nr.536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet dhe transferohet në pronësi të Bashkisë Durrës, për njësinë administrative Durrës, një pjesë e pasurisë me numër 147/24, me sipërfaqe prej 400 000 m², me vendndodhje në zonën kadastrale 8517, sipas formularit dhe planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në funksion të procesit të rindërtimit në njësinë administrative Durrës për të prekurit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

2. Ngarkohen Bashkia Durrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4479/1
DATË 30.9. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
BASHKISË DURRËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

